



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 5, date 18.01.2019

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E VALENTIN KOLA DHE NDUE PAPLEKAJ, BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 18.01.2019, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 54 shkronja “dh”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr. 82, datë 20.12.2018 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 të Bashkisë Shkodër”, Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Valentin Kola** (5 anëtarë familje) në vlerën prej **100.000 lekë** (njëqind mijë), për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Ndue Papekaj** (8 anëtarë familje) në vlerën prej **100.000 lekë** (njëqind mijë), për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
3. Burimi i financimit është fondi i emergjencave civile në programin P03280 “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile” në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin

2019, në programin P03280, O1 A2 "Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie", në vlerën 200,000 lekë.

4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjet e Valentin Kola dhe Ndue Papekaj.
5. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 186,555 lekë (*njëqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë*) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 155,000 lekë (*njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë*) sipas preventivava të komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Valentin Kola**, në total **341,555 lekë** (*treqind e dyzet e një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë*).
6. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 324,677 lekë (*treqind e njëzet e katërmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë*) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 292,880 lekë (*dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë*) sipas preventivava të komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z. **Ndue Papekaj**, në total **617,557 lekë** (*gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë*).
7. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjet e Valentin Kola dhe Ndue Papekaj, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
8. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës prej 200,000 lekë (*dyqind mijë*).
9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 18.1.2019

Shpallur në datën 21.1.2019

Sekretar i këshillit



Suel Hadri



Pr. 1725, 04.02.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR
SEKTORI JURIDIK

Nr. 91/1 prot.

Shkodër, më 01.02.2019

LËNDA: Lidhur me vendimin nr. 5, datë 18.01.2019 të Këshillit Bashkiak Shkodër.

KËSHILLI BASHKIAK SHKODËR

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin”, neni 8, gërma a, të ligjit nr. 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”, neni 29, neni 54, gërma dh, neni 55, pika 3, neni 64, gërma c, të ligjit nr. 8756, dt. 26.03.2001 “Per emergjencat civile”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, neni 56, të VKM nr. 329, dt. 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III të Udhëzimit të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, dt. 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore”, të shkresave të MPB nr. 7007 prot., dt. 20.10.2016, nr. 806 prot., dt. 08.02.2017, nr. 3950 prot., dt. 21.06.2017, shqyrtoi **VKB Shkodër nr. 5, datë 18.01.2019 “Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Valentin Kola dhe Ndue Papekaj, banesa e të cilëve është dëmtuar nga zjarri”.**

Pas shqyrtimit të vendimit, Prefekti ju autorizon procedimin e mëtejshëm.

Me respekt,

P R E F E K T I

Çesk MILLJA

